



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.

DREJTORIA E PROKURIMIT DHE ANKANDIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më \_\_\_/ 06/2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Projekt implementimi i infrastrukturës së rrjetit, sigurisë, server dhe storage për shoqërinë Albpetrol sh.a.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 48800000-6 - Sisteme informacioni dhe servera, 48820000-2 - Servera, 48821000-9 - Servera rrjeti, 48822000-6 - Servera kompjuterikë, 48823000-3 - Servera dokumentash

VLERA E FONDIT LIMIT: 106,097,336 (njëqind e gjashtë milion e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 19.06.2023): 982,655 (nëntëqind e tetëdhjet e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Bazuar në nenin 39 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” parashtrijmë arsyet kryesore për vendimin e mosndarjen në lote për këtë procedurë.

Albpetrol sh.a. është një shoqëri aksionere me 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti shqiptar. Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Patosit. Roli kryesor i shoqërisë është prodhimi dhe tregtimi i produkteve të naftës si dhe monitorimi i Marrëveshjeve Hidrokarbure.

Aktualisht Albpetrol sh.a. i ofron punonjësve të saj infrastrukturën dhe shërbimet bazë TIK, të cilat përfshijnë rrjetin kompjuterik lokal dhe internet, infrastrukturën qendrore për ruajtjen dhe perpunimin e të dhenave, komunikimin etj të perbere nga servera, storage dhe pajisje desktop për punonjësit si dhe sistemi GIS i hedhjes, perpunimit dhe ruajtjes së të dhenave gjeohapësore.

Infrastruktura ekzistuese është e amortizuar dhe e vjetëruar nga pikëpamja e zhvillimeve teknologjike moderne. Shumë prej pajisjeve janë EOL (janë zëvendësuar nga një gjeneratë e re produkte) dhe pjesa më e madhe e softëare dhe licencave janë pa suportin e prodhuesit.

Gjithashtu, nisur nga situata aktuale ku sulmet keqdashëse kibernetike janë bërë kaq prezente dhe të shpeshta edhe në vendin tonë janë rekomanduar investime domethënëse në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në aplikimin e teknologjisë së informacionit.

Këto investime dhe projekte jo vetëm do garantojnë siguri dhe efikasitet por do të kontribuojnë gjithashtu në përmirësimin dhe përshpejtimin e procedurave dhe proceseve të punës dhe të shërbimeve që Albpetrol sha ofron.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i vijueshëm i aktivitetit të operimeve tregtare të përditshme në Albpetrol, me anë të investimeve në teknologjinë e informacionit, më konkretisht në digjitalizimin, unifikimin dhe harmonizimin e procedurave dhe proceseve të punës të Albpetrol.

Ky shërbim duhet të kryhet për të gjithë ndërtesën me 3 kate të Albpetrol sha. Në total llogariten 200 poste pune për të cilat duhet realizuar kabllimi, kanalizimi, instalimi i prizave, lidhja në patch panel, testimi, etiketimi etj. Kabllimi duhet të kryhet i tillë që secili post pune të lidhet direkt me pajisjet 'switch' të njeve të rrjetit, duke shmangur vendosjen e pajisjeve të tjera ndërmjet (cascade). Kjo duhet për përcaktimin e politikave të aksesit nga pajisjet e rrjetit dhe për të shmangur komunikimet paralele, në rast të problemeve që mund të shkaktojë një pajisje e kompromentuar. Instalimet e rrjetit duhet të kenë mbrojtje nga interferencat nga kabllot ose burimet e ndryshme të fuqisë.

Për sa më sipër kjo është një procedurë e cila nuk mund të ndahet në lote për shkak të kompleksitetit të saj gjithashtu projekti konsiderohet dhe do të implementohet si një i vetëm.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 76, 82 dhe 83 të LPP, nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriteve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, të konfirmuar nga administrata tatimore

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

#### Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të furnizuara.
- OSE**
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO ose të përditësuara, ose ekuivalente (të vlefshme dhe të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

- ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë".
- ISO 20000-1:2011 mbi "Menaxhimin e shërbimit".
- ISO 22301: 2012 mbi "Krijimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të sistemeve të menaxhimit".
- ISO 27001:2013 mbi "Sistemet e menaxhimit të sigurisë informatike".

**Argumentimi:** Kërkesa për këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar dhe nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik".

ISO 9001-2015 - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rreziqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruara janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 20000-1:2011 - Ky standard është i nevojshëm për të specifikuar kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të shërbimit. Ky sistem mbështet menaxhimin e ciklit jetësor të shërbimit, duke përfshirë planifikimin, projektimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve që plotësojnë kërkesat e dakorduara dhe u japin vlerë konsumatorëve, përdoruesve dhe organizatës së ofruesit të shërbimit. Ky standard u jep mundësi kompanive të demonstrojnë aftësitë e tyre profesionale në zbatimin e projekteve të teknologjisë së informacionit.

ISO 22301:2012 - Ky standard është i nevojshëm pasi është krijuar për të ndihmuar organizatat të parandalojnë, përgatiten, përgjigjen dhe rikuperohen nga incidentet e papritura që shkaktojnë ndërprerje të punës. Ky standard u jep mundësi kompanive të demonstrojnë aftësitë e tyre profesionale në zbatimin e projekteve të teknologjisë së informacionit.

ISO 27001:2013 - Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshin kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura me nevojat e organizatës, në mënyrë që informacioni të mbetet i sigurt dhe siguria e sistemeve të saj të mos rrezikohet nga sulmet kibernetike.

*Sa më sipër janë kërkuar certifikata që vërtetojnë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standardeve ndërkombëtare, të cilat reflektojnë qartë në cilësinë e shërbimit. Kërkesat janë të mjaftueshme për t'u pajisur ofertuesit me kapacitete teknike cilësore të certifikuara me certifikata të njohura ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë. Certifikatat e kërkuara për OE janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Certifikatat e kërkuara janë vendosur në përputhje me specifikimet teknike dhe janë vlerësuar të nevojshme për të siguruar ofertues serioz.*

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqes autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për pajisjet dhe platformat e kërkuara. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që verteton lidhjen e distributorit të autorizuar me firmën prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se mallrat e ofruara janë konform të gjitha standardeve dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.4. Katalog teknik/skede teknike, nga firma prodhuese për pajisjet hardware të kërkuara përkatësisht nr. 2,3,4,5,7,8,9,10,11,12,13,14,15 sipas shtojcës 6 tabela e sasive. Katalogu/skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të pajisjeve si më sipër, që janë objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në katalogun/skeden e paraqitur të shenohen në mënyrë të dukshme pajisjet si më sipër me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. (Pjesët specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e mallit që prokurohet nëq nuk janë në gjuhën shqipe të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se malli i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.5. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, duhet të ketë staf teknik minimalisht 6 (gjashtë) punonjës

te diplomuar me arsim të lartë, të certifikuar nga prodhuesit e pajisjeve për produktet e kërkuara sipas shtojcës 6.

Për secin punonjes të paraqiten:

- Diploma e arsimit të lartë përkatëse.
- Listepagesat e shoqerise per te paktën tre muajt e fundit ne te cilat punonjësit e sipërpërmendur duhet te figurojne.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjës janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë staf teknik te kualifikuar për implementimin e projektit, sipas certifikatave te meposhtme:

- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projektit, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar për zbatimin e infrastrukturës së rrjetit, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për pajisjen e rrjetit të tipit switch që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për pajisjen e rrjetit pa tela që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për pajisjet firewall që do të furnizohen dhe instalohen, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i pajisjes së serverit që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve të ruajtjes që do të furnizohen dhe instalohen, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i sistemit të virtualizimit që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për platformën Microsoft (Microsoft 365, Server, Azure, etj.), ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i platformës së menaxhimit të aksesit të përdoruesit, ose ekuivalent.

Pranohen rastet kur një punonjes disponon më shumë se një certifikatë, por që në mënyrë të kombinuar stafi të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmimeve të kërkuara.

Për secin punonjes të paraqiten:

- Certifikata përkatëse.
- Listepagesat e shoqerise per te paktën tre muajt e fundit ne te cilat punonjësit me certifikatat e sipërpërmendura duhet te figurojne.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjës të certifikuar janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kërkesat për punonjësit e mësipërm janë hartuar duke iu referuar termave të referencës.

- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projektit, ose ekuivalent. Operatori ekonomik duhet të ketë patjetër një punonjës të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm dhe rigoroz të projektit.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar për zbatimin e infrastrukturës së rrjetit, ose ekuivalent. Ky certifikim na ndihmon të vlerësojmë njohuritë dhe aftësitë profesionale të operatorit ekonomik, për zbatimin e projektit në lidhje me zbatimin e pjesës së infrastrukturës së rrjetit të këtij projekti.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për pajisjen e rrjetit të tipit switch që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent. Ky certifikim është një kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik që do të kryejë shërbimin për shkak të ngarkesës dhe numrit të konsiderueshëm të pajisjeve “switch” që përfshin infrastruktura.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për pajisjen e rrjetit pa tela që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent. Ky certifikim është një kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik që do të kryejë shërbimin e dorëzimit, instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve të pikave të aksesit me valë të përfshira në këtë projekt.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për pajisjet firewall që do të furnizohen dhe instalohen, ose ekuivalent. Ky certifikim është një kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik i cili do të kryejë shërbimin e përgatitjes, instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve firewall të përfshira në këtë projekt.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i pajisjes së serverit që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent. Ky certifikim është një kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik i cili do të kryejë shërbimin e dorëzimit, instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve të serverit që përfshin ky projekt.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve të ruajtjes që do të furnizohen dhe instalohen, ose ekuivalent. Ky certifikim është një kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik që do të kryejë shërbimin e dorëzimit, instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve të magazinimit që përfshin ky projekt.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i sistemit të virtualizimit që do të furnizohet dhe instalohet, ose ekuivalent. Ky certifikim është një kriter i rëndësishëm për përzgjedhjen e operatorit ekonomik sepse makinat ku do të instalohen platformat e kërkuara do të vendosen me anë të softuerit të virtualizimit dhe OE duhet të demonstrojë aftësinë për të përdorur këtë softuer virtualizimi.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi për platformën Microsoft (Microsoft 365, Server, Azure, etj.), ose ekuivalent.



Ky certifikim është një kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik që do të kryejë shërbimin e dorëzimit, instalimit dhe konfigurimit të platformës Microsoft që përfshin ky projekt.

- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i platformës së menaxhimit të aksesit të përdoruesit, ose ekuivalent.

Ky certifikim është një kriter i rëndësishëm për përzgjedhjen e operatorit ekonomik sepse OE duhet të demonstrojë aftësinë për të instaluar, konfiguruar dhe menaxhuar këtë platformë.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Shënim: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushes pranë Autoritetit Kontraktor të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit. *Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### **Njësia e Prokurimit:**